

Hapet thirrja për bursa në programin Erasmus + në Universitetin e Graz-it në Austri për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020.

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete në Universitetin e Graz-it, në kuadër të programit Erasmus +, për studentët e UT-së për studime, për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Bachelor;
- Master;
- Doktoraturë;

Për më shumë informacion referohuni:

<https://international.uni-graz.at/en/stud/incoming/about-uni-graz/>

https://static.uni-graz.at/fileadmin/bib/downloads/studierende/incoming/ugo/bibwww_s_ugo_guidelines.pdf

https://online.uni-graz.at/kfu_online/wbENLVSuche.wbEnLvSuchePage

Kohëzgjatja e bursave:

- Bachelor, Master, Doktoraturë (1 semestër)

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (800 EUR në muaj)
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe / ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Procedura e aplikimit dhe dokumentat e nevojshme për aplikim:

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Bachelor**:

- CV (në gjuhën angleze/gjermane);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose gjermane);
- Listë notash bachelor (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose gjermane);
- Letër Motivimi në gjuhën angleze/gjermane në varësi të programit të studimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B2/Gjermanisht B2 në varësi të programit të studimit);
- *Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillojë në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Graz-it lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ tek seksioni ‘‘Commitment’’ firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën: http://www.unitir.edu.al/images/Learning_Agreement_Graz.docx

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Master**:

- CV (në gjuhën angleze/gjermane);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose gjermane);
- Diplomë e nivelit Bachelor;
- Listë notash e nivelit Bachelor (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose gjermane);
- Listë notash e nivelit Master (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose gjermane);
- Letër Motivimi në gjuhën angleze/gjermane në varësi të programit të studimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B2/Gjermanisht B2 në varësi të programit të studimit);
- *Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvilloni në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘‘Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Graz-it lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen

kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillonit/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ tek seksioni ‘‘Commitment’’ firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Learning_Agreement_Graz.docx

Dokumentat e nevojshme për aplikim për nivelin **Doktoraturë**:

- CV (në gjuhën angleze/gjermane);
- Lista e publikimeve (në gjuhën angleze/gjermane);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose gjermane);
- Listë notash doktorature (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose gjermane);
- Letër motivimi + Përshkrim të temës së kërkimit (në gjuhën angleze/gjermane në varësi të fushës së mobilitetit);
- Letër e mbikqyrjes nga stafi akademik në Universitetin e Graz-it;

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Letter-of-Supervision_Graz.doc

- Certifikata e gjuhës së huaj niveli B2 (Anglisht/Gjermanisht sipas programit të studimit)

** Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillonit në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘‘Before the mobility’’. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Graz-it lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillonit lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës. Nëse ju nuk do të

frektoni lëndë dhe nuk do të merni kredite në universitetin pritës por do të shkoni vetëm për hulumtim atëherë duhet ta përcaktoni këtë gjë në dokumentin Learning Agreement.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Learning_Agreement_Graz.docx

Afati për aplikim: 15 Prill 2019

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si edhe të skanuara përmes postës elektronike në adresën iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!